

FJALA E DEPUTETIT ILIR METAJ

E ENJTE 30 QERSHOR 2022

Ka mbi 30 vjet që shoqëria shqiptare mundohet me mish e me shpirt të ndërtojë një shtet të së drejtës, ku gjithkush që jeton e punon në respekt të moralit e të ligjit, dhe ku gjithkush meriton të mbrohet sa herë ka nevojë, nga morali dhe nga ligji. Shteti shqiptar, për meritë të fitores së demokracisë, nuk është më diktaturë e proletariatit. Ama duket qartazi, që tek disa këtu, struktur thellë në ndërgjegjen e tyre, ekzistojnë atavizma të së shkuarës, nëpërmjet të cilave mundohen të manipulojnë zhvillimin e ekonomisë së tregut. Në ekonominë e tregut rolet ndahen sipas aftësisë, zgjedhjeve, mundit, sakrificës, djersës, pse jo dhe të fatit. Parë nga ky këndvështrim kompleks, dikujt i takon të bëjë sipërmarrësin.

Kjo do të thotë se ka meritën të punësojë qindra e mijëra njerëz, të zhvillojë qytete dhe tek e fundit t'i japë shoqërisë arsye se përse duhet të shkollohet, të punojë e të jetojë e punojë në këtë vend. Në ekonominë e tregut as shteti nuk është pronar i mjeteve të prodhimit, por ai financon punë publike nëpërmjet prokurimeve publike. Duke fituar të drejtën ligjore për të kryer një punë publike, sipërmarrësi garanton njëkohësisht angazhimin e të gjitha burimeve të tij, për të bërë atë që ai di të bëjë më mirë, që do të thotë: të krijojë, të ndërtojë, të zhvillojë. Tek e fundit, ai bën atë gjë për të cilën ai ekziston: punon.

Çdokush që punon sipas ligjeve, qoftë individ apo shoqëri, meriton edhe të mbrohet nga këto ligje, por falë opozitës dhe retorikës së saj copy-paste, destruktive, që e ka origjinën te atavizmat e të shkuarës dhe gjallon përmes manipulimeve arkaike të tipit “punëtori kundër kapitalistit”, po tentohet fort, çdo ditë e më tepër, të bëhet pis emri i sipërmarrësit shqiptar. Çdo ditë dëgjon shprehje të tilla si: X oligark mori Y tenderë e të tjera e të tjera. Më duhet të them se termi “oligark” nuk ka vend në realitetin shqiptar, por megjithatë po e përdor për t'i ardhur pas avazit atyre që e kanë me qejf ta përdorin. Pra, thuhet se X oligark mori Y tenderë, a thua se i mori dhe i futi të gjitha në xhep, pa dhënë asgjë në këmbim.

Zotërinj deputetë,

Nëse dikush në institucione shtetërore abuzon me ligjin, goditeni fort, me fakte dhe me argumente të arsyeshme. Nëse dikush shet një mall më shtrenjtë nga ç'e ka vlerën ai mall, e për këtë gjen blerës, fajin e ka blerësi. Nëse dikush mundohet të abuzojë me lirinë e ekonomisë së tregut dhe të deformojë procesin, duke manipuluar të drejtën e konkurrencës, faji është individual dhe asnjëherë i tërë klasës së sipërmarrësve shqiptarë që aktivizohen në punën publike. Nëse një kompani është e specializuar në ndërtim rrugësh, ajo patjetër do të jetojë nga konkurrencët për punët publike, pasi rrugët financohen nga shteti. Nëse një kompani është e specializuar në fushën e kanalizim-ujësjellësit, ajo patjetër që ekziston nëpërmjet tenderëve publik, pasi kanalizim-ujësjellësit janë pronë publike.

Por pavarësisht kësaj, opozitës i mjafton të citojë se X kompani e Y individ është oligark i preferuar, sepse ka fituar shumë tenderë. Kaq mjafton. Asnjë analizë ekspertësh të mirëfilltë të fushës, dhe kur them këtë s'e kam fjalën për ekspertë të tipit $7 \times 7 = 42$. Kostoja e veprave të mëdha nuk llogaritet me gishta nga facebook-u, se përndryshe do të ishte një lloj si t'i bënim petullat me ujë. Nuk është kjo qasja e qeverisë socialiste. Qasja e qeverisë socialiste është ajo e të kujdesurit për të punësuarin, kur ai ngelet i papunë për shkak të pandemisë. Qasja e qeverisë socialiste është ajo e të strehuarit në kohë rekord për të gjithë të dëmtuarit nga tërmeti. Qasja e qeverisë socialiste është ajo e të qenit pranë hallit, në zgjidhje të hallit. E mos thoni pastaj se mbështetja financiare e qeverisë socialiste ishte më e ulëta krahasuar me aty apo këtu.

Mjafton të përmendim faktin që efekti negativ i pandemisë në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë pati ndikimin më të ulët në rajon e më gjerë, e kjo pikërisht për shkak të ndërhyrjes së qeverisë socialiste në kohë dhe në mënyrat e duhura. Po me të njëjtën përgjegjësi dhe për të njëjtat motive, qeveria qëndron edhe pranë sipërmarrësve, duke synuar të jetë e drejtë brenda të drejtës publike. Askush nuk mund të mohojë se viti 2022 filloi me një rritje të pazakontë të nivelit të çmimeve, madje edhe që përpara luftës në Ukrainë, për arsye që lidheshin me post-pandeminë. Ndërsa inflacioni qëndron në nivelet e 6-7%, ka produkte të caktuara, të cilat kanë arritur në luhatje të niveleve të çmimeve deri në 40%.

Këtu bëhet fjalë për produkte të rëndësishme të punëve publike, sikundër janë metalet, plastika, çimentoja, bitumi. Këto zëra si metalet, plastika, çimento e bitumi, për shkak të

natyrës së tyre, zënë vend të konsiderueshëm pikërisht në investimet publike. Arsyet e rritjeve të tilla jashtë imagjinatës dhe për shkak të forcave madhore nuk mund të parashikohen kurrë në kontrata, të cilat bëhen në kohë normale, sepse kontratat e bëra në kohë normale mund të parashikojnë luhatje 5 % deri në 10 %, por asnjëherë situata të tilla deformuese, që mund të çojnë deri në falimentim të kompanive. Për këtë arsye, shteti duhet të jetë aty, i gatshëm të ndajë rrezikun, i detyruar të tregohet i drejtë, pasi barra nuk mund të jetë asnjëherë e njëanshme. Nëse ka një mënyrë për të dalë faqebardhë nga krizat, është të mbrosh sa më shumë burimet prodhuese, të sigurosh që ato u mbijetojnë krizave dhe që ekonomia e vendit nuk humbet kapitalin e saj.

Këtë synon të bëjë edhe ky akt normativ: të lejojë shtetin të tregohet i drejtë brenda kufijve të mirëcaktuar, madje të monitorojë edhe zbatimin e tij me rigorozitet. Ashtu siç është konturuar fushëveprimi në këtë akt normativ, është e vështirë të ketë keqpërdorime, por edhe nëse ka përpjekje të tilla, ekzistojnë të gjitha instrumentet për t'i gjurmuar ato. Ky yni është një shtet ligjor. Në një shtet ligjor është ligji ai që ndan të drejtën nga e gabuara, fajtorin nga i pafajshmi dhe të dëmtuarin nga dëmtuesi. Çdo gjë tjetër është propagandë. Aq më tepër kur bëhet fjalë për një propagandë të tillë, të tipit: hidh baltë mbi këdo dhe kudo, që në fakt është një alibi për të mbrojtur të korruptuarit e vërtetë. Ky është një dëm shumë i madh që i bëhet virtytit në Shqipëri.

Prandaj, të nderuar kolegë, ta miratojmë këtë ligj dhe të bëjmë atë për të cilën kemi ndërmarrë misionin për të qenë në këtë sallë: të ndërtojmë ligje të mira e të drejta, e më pas të ushtrojmë tërë fuqinë që na jep ligjvënësi për të kontrolluar zbatimin me rigorozitet e në mënyrën e duhur të këtij akti normativ. Faleminderit!